



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E PERSONELIT DHEINSPEKTIMIT

U R D H E R

Nr. 62 datë 19 .02.2004

Për caktimin e subjekteve që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në Inspektoriatin e Ulët.

Në mbështetje të neneve 3 pika 2 të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financjare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ",

U R D H E R O J:

1. Në strukturën e organit të prokurorisë, të përfshihen në listën e subjekteve që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë pranë Inspektoriatit të Ulët, funksionet e më poshtëme;

- ❖ drejtorët e drejtorive në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme
- ❖ përgjegjës të zyrave dhe të sektorit në administratën e Prokurorisë të Përgjithshme.
- ❖ punonjësit e zyrës së prokurimeve dhe antarët e komisione-ve të prokurimeve.
- ❖ inspektorët e Drejtorisë të Kontrollit Financjar në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme
- ❖ oficerët e policisë gjyqësore në të gjitha nivelet e organit të prokurorisë.
- ❖ kancelarët dhe përgjegjës të zyrave të" financës dhe buxhetit në prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe në prokuroritë e apeleve.

2. Me këtë urdhër të njihen të gjithë punonjësit e prokurorive që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

PROKURORI I PERGJITHSHEM
THEODHORI SOLLAKU